

VENDIM
Nr.479, datë 12.7.2006

**PËR DHËNIE FONDI BUXHETOR KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR, PËR PROMOVIMIN E
DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshillit të Ministrave

VENDOSI:

1. Kryqit të Kuq Shqiptar t’i jepet fondi buxhetor prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.
 3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Financave dhe presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha